

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shtator 2024

Tiranë, më 25 Tetor 2024: Gjatë muajit Shtator 2024, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 1.794.274 shtetas shqiptar dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 8,7 %, krahasuar me Shtator 2023.


1.927.816 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 12,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve

Në Shtator 2024, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 648.184, duke pësuar një rritje me 18,6 %, krahasuar me Shtator 2023.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 1.146.090. Ky numër është rritur me 3,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 (fig.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Shtator 2023-Shtator 2024



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 25/10/2024

Daljet e shtetasve

Në muajin Shtator 2024, 698.268 shtetas shqiptarë numërohen të kenë dalë nga territori i Shqipërisë, duke shënuar rritje me 14,2 %, krahasuar me Shtator 2023.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shtator 2024, janë 1.229.548. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues është rritur me 11,7 % (tab.1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Shtator 2023	Shtator 2024	Ndryshimi vjetor %	Janar – Shtator 2023	Janar – Shtator 2024	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	1.650.506	1.794.274	8,7	13.401.915	15.617.566	16,5
Shqiptarë	546.316	648.184	18,6	5.107.315	5.937.536	16,3
Të Huaj	1.104.190	1.146.090	3,8	8.294.600	9.680.030	16,7
Dalje Gjithsej	1.711.815	1.927.816	12,6	13.116.415	15.458.264	17,9
Shqiptarë	611.497	698.268	14,2	5.198.846	5.978.134	15,0
Të Huaj	1.100.318	1.229.548	11,7	7.917.569	9.480.130	19,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Shtator 2024, 95 % e hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri janë nga rajoni i Evropës.

Evropa Jugore zë 69 % të hyrjeve të shtetasve të huaj nga kontinenti Evropian, ndjekur nga Evropa Perëndimore me 12 % (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Shtator 2023	Shtator 2024	Janar-Shtator 2023	Janar-Shtator 2024
Gjithsej	1.104.190	1.146.090	8.294.600	9.680.030
I. Afrika	1.192	5.172	8.537	24.490
II. Amerika	29.236	33.574	200.534	257.277
III. Azia Lindore dhe Paqësori	8.958	13.734	53.906	77.243
IV. Lindja e Mesme	2.564	2.499	37.062	25.963
V. Azia e Jugut	1.342	3.467	10.898	20.599
VI. Evropa	1.059.798	1.085.038	7.963.158	9.222.931
- Evropa Qëndrore / Lindore	95.353	122.890	572.442	758.508
- Evropa Veriore	43.032	54.758	313.990	407.428
- Evropa Jugore	795.321	749.345	6.271.500	6.939.827
- Evropa Perëndimore	100.987	125.784	634.710	829.077
- Evropa Lindore/ Mesdheut	25.105	32.261	170.516	288.091
VII. Rajone të paspecifikuara	1.100	2.606	20.505	51.527

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Qëllimi i hyrjes në territorin shqiptar i shtetasve të huaj, në 98 % të rasteve është për qëllime personale, ku dominojnë hyrjet për Pushime, vizitë tek të afërm, etj. Në Shtator 2024, ky tregues ka shënuar një rritje me 0,9%, krahasuar me Shtator 2023. Rritje të ndjeshme në muajin Shtator kanë patur edhe hyrjet e shtetasve të huaj për qëllime Biznesi dhe profesionale, me 60,9 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Shtator 2023	Shtator 2024	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Shtator 2023	Janar-Shtator 2024	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje shtetas të huaj	1.104.190	1.146.090	3,8	8.294.600	9.680.030	16,7
I. Personale	1.092.968	1.128.033	3,2	8.195.585	9.524.756	16,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm. etj.	1.045.778	1.054.937	0,9	7.791.228	9.195.205	18,0
2. Trajtime shëndetësore	11	53	381,8	619	545	-12,0
3. Qëllime fetare	24	17	-29,2	347	303	-12,7
4. Udhëtarë transit	47.155	73.026	54,9	403.391	328.703	-18,5
II. Biznes dhe profesionale	11.222	18.057	60,9	99.015	155.274	56,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambientit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë informacion referojuni:

<https://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> Politika e Revizionimit Statistikor.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.

- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.